



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA

**ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE**

Nr. i Dokumentit: 21.4.1-2016-08

**RAPORTI I AUDITIMIT
PËR RAPORTIN FINANCIAR VJETOR TË AKADEMISË SË
SHKENCAVE DHE ARTEVE TË KOSOVËS
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2016**

Prishtinë, qershor 2017

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhimin e shëndoshë financiar në administratën publike. Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Valbon Bytyqi, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nga Luljeta Sylaj Udhëheqëse e ekipit, me anëtarët e ekipit Ariana Berisha-Rexhëbeqaj dhe Arnisa Aliu, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Bujar Bajraktari.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	6
2 Qeverisja.....	9
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	12
Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit	16
Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA.....	17
Shtojca III: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak	19
Shtojca IV: Letërkonfirmimi	20

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky Raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Raportit Financiar Vjetor të Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës për vitin 2016, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2016 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit¹, të datës 08/12/2016.

Auditimi ynë është fokusuar në (është dhënë në hollësi në Shtojcën 1):



Niveli i punës së kryer nga Zyra Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2016 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i pa modifikuar

Pasqyrat Financiare Vjetore *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.

Për më gjerësisht shih pjesën 1.2 të këtij Raporti.

Shtojca II, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Falënderojmë Kryetarin e Akademisë dhe stafin e tij për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

¹ Termi "Plani i Jashtëm i Auditimit" është zëvendësim i termit "Memorandumi i Planifikimit të Auditimit"

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore



Përgjigja e Kryetarit të Akademisë – auditimi 2016

Kryetari i akademisë ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me të gjeturat e detajuara dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do ti adresoj rekomandimet e dhëna.

1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Hyrje

Rishikimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacioneve të shpalosura në PFV. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave (MF).

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacioneve në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

1.1 Opinioni i auditimit

Opinion i pamodifikuar

Kemi audituar PFV-të e Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës (AShAK) për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, si dhe shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë PFV për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore.

Baza për opinion

Kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave përgjegjës për qeverisje dhe PFV-të

Sekretarja e Përgjithshme e Akademisë është përgjegjëse për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe është përgjegjës për kontrole të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të

mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Kryetari i Akademisë dhe Sekretarja e Përgjithshme janë përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të AShAK-ut.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim që kryhet në pajtim me SNISA-t do të zbulojë një keq-deklarim material kur ekziston. Keq-deklarimet mund të rrjedhin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

1.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Nga ASHAK kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048, i ndryshuar me Ligjin nr.03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116 dhe Ligjin nr. 04/L-194;
- Raportimet në Kryesinë e Akademisë;
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr.01/2013;
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr.02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Raportet tremujore duke i përfshirë këtu edhe pasqyrat nëntëmujore financiare;
- Raportet për faturat e papaguara;
- Planin e prokurimit dhe raportin e kontratave të nënshkruara të prokurimit; dhe
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK).

Në kontekst të PFV-ve, nuk kemi asnjë çështje për të ngritur.

Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të draft PFV-ve në Ministrinë e Financave, mund të konsiderohet e saktë për shkak se gjatë auditimit nuk janë identifikuar gabime.

Në kontekst të kërkesave tjera për raportim të jashtëm, të gjitha kërkesat janë përmbushur.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime lidhur me PFV-të.

2 Qeverisja

Hyrje

Aranzhimet efektive të qeverisjes janë thelbësore për AShAK-un që të menaxhojë në mënyrë të suksesshme sfidat me të cilat përballet dhe të sigurojë ofrimin e shërbimeve më të mira në dobi të taksapaguesve dhe të shfrytëzuesve tjerë të shërbimeve.

Një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se menaxhmenti është duke u munduar t'i zhvilloj proceset ekzistuese dhe kontrollet. Në mënyrë të ngjashme, pyetësi i vet-vlerësimit siguron një kornizë për zhvillimin e aranzhimeve të zgjeruara të qeverisjes. Është e rëndësishme që përgjigjet e dhëna të jenë të mbështetura me dëshmitë përkatëse.

Pjesa e rishikimit të aranzhimeve të qeverisjes pasqyron një shqyrtim të:

- fushave të aranzhimeve të qeverisjes ku nevojiten përmirësime të rëndësishme dhe ku besojmë se rekomandimet tona mund të gjenerojnë përmirësime pozitive, duke e përfshirë edhe shqyrtimin e sistemit të Auditimit të Brendshëm; dhe
- fushave të menaxhimit financiar dhe kontrollit të identifikuar përmes punës sonë të auditimit, duke përfshirë punën specifike të drejtuar në çështjet e pajtueshmërisë në sistemet kyçe të të hyrave dhe shpenzimeve (këto fusha janë shqyrtuar në kapitullin 3 të këtij Raporti).

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Qeverisja në AShAK sa i përket raportimit menaxherial dhe llogaridhënies, si dhe menaxhimi i rrezikut pasqyrojnë një situatë pozitive. AShAK ka zbatuar rekomandimet e Auditorit të Përgjithshëm si dhe ka përgatitur raport në lidhje me menaxhimin e rrezikut.

2.1 Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak

Raporti ynë i auditimit për PFV-të e AShAK-ut të vitit 2015 ka rezultuar në tri (3) rekomandime. AShAK kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitej mënyra se si do të zbatohen të gjitha rekomandimet. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2016 të tri (3) rekomandimet ishin zbatuar.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

2.2 Pyetësi i vet-vlerësimit të komponentëve të MFK-së

MF ka hartuar një pyetësor të detajuar të vet-vlerësimit për organizatat buxhetore për të mbështetur aranzhimet efektive të qeverisjes. Për të gjitha auditimet e ndërmarra, ne kemi testuar cilësinë e pyetësorëve të vet-vlerësimit të MFK-së të dorëzuara në Ministri, duke vlerësuar nga një pyetje kyçe në secilën komponentë të pyetësorit. Kjo nuk ka për qëllim të japë koment për cilësinë e tërë pyetësorit të vet-vlerësimit por do të pasqyrojë gjendjen për një numër të pyetjeve kyçe për të mbështetur përpjekjet e MF-së në rritjen e efektivitetit të procesit dhe në zhvillimin e sistemit të MFK-së në tërësi.

Si pjesë e auditimit tonë, i kemi shqyrtuar çështjet kyçe të pyetësorit të vet-vlerësimit në lidhje me pesë komponentë të tij. Bazuar në këtë konstatuam se:

- Pyetësi i vet-vlerësimit i plotësuar nga AShAK ka vërtetuar se sistemet e kërkuara të menaxhimit të rrezikut ishin funksionale. Procedurat për menaxhimin e rrezikut janë vendosur në fund të vitit 2016 dhe po ashtu është krijuar plani për menaxhimin e rrezikut 2017-2019. Lista e rreziqeve është bazuar në planin vjetor të organizatës; dhe
- Lidhjet në mes të planit të prokurimit dhe të buxhetit si dhe përpilimi i raporteve adekuate në baza të rregullta kohore konsiderohen si të vendosura, dhe dëshmitë e ofruara e mbështesin këtë konkluzion.

Çështja 1 – Mungesa e planit strategjik – Prioritet i lartë

E gjetura	Sipas kërkesave të MFK-së, planet strategjike hartohen për një periudhë mbi tri (3) vjeçare. Akademia nuk kishte hartuar planin strategjik gjithëpërfshirës. Megjithatë në planin vjetor për sektorë të ndryshëm ishin përcaktuar edhe aktivitete që kanë të bëjnë me periudha më të gjata se një vit.
Rreziku	Mungesa e planit gjithëpërfshirës strategjik mund të ndikojë që të punësuarit të mos i kenë të qarta synimet afatgjata të institucionit. Rrjedhimisht kjo mund të ndikojë edhe në arritjen e objektivave dhe synimeve të AShAK.
Rekomandimi 1	Kryetari i Akademisë duhet të sigurojë se ka hartuar planin strategjik gjithëpërfshirës në mënyrë që synimet e organizatës të përcaktohen në terma më afatgjatë. Progresi i arritjes së synimeve duhet të monitorohet në baza të rregullta kohore për të vlerësuar rezultatet e arritura.

2.3 Raportimi menaxherial dhe llogaridhënia

Menaxhmenti ka zbatuar një sërë kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet financiare funksionojnë siç duhet. Ato kontrole përfshijnë raportimin e duhur tek menaxhmenti për të mundësuar një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara. Raportimi menaxherial përfshirë raportimin financiar tek menaxhmenti ishte i rregullt dhe cilësor.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

2.4 Sistemi i auditimit të brendshëm

Në bazë të kërkesave të parapara me udhëzimin Administrativ nr.23/2009 për themelimin e Njesisë së Auditimit të Brendshëm (NjAB), AShAK nuk i plotëson kushtet për themelimin e NjAB-së. Në mungesë të NjAB-së auditimi i brendshëm kryhet nga Departamenti i Auditimit të Brendshëm (DAB) në kuadër të MF-së. DAB në bazë të kërkesës së AShAK në vitin 2016 kishte kryer një auditim lidhur me "Aktivitetet e prokurimit dhe menaxhimin e kontratave të vitit 2015".

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Hyrje

Puna jonë për MFK-në jashtë fushave të qeverisjes të përmendura në kapitullin dy, pasqyron punën e detajuar të ndërmarrë për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Si pjesë e kësaj, ne konsiderojmë menaxhimin e buxhetit, çështjet e prokurimit dhe të burimeve njerëzore si dhe pasuritë dhe detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

AShAK në përgjithësi ka kontrolle të mira në raport me obligimet statutores të saj. Menaxhimi financiar dhe kontrolli kanë dëshmuar proces të mirë të rishikimit dhe siguri në zbatimin e legjislacionit dhe proceseve të tjera të kontrollit.

AShAK ka përdorur 99% të buxhetit final, që paraqet një përqindje të lartë të realizimit. Rishikimi i kontrolleve menaxheriale të zbatuara në sistemin kryesor financiar ka nxjerrë në pah një raportim të mirë financiar mbi shpenzimet dhe të hyrat.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar të hyrat e arkëtuara, burimet e fondeve buxhetore, si dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Të hyrat e inkasuara për buxhetin e Kosovës (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2016 Pranimet	2015 Pranimet	2014 Pranimet
Të hyrat jotatimore	-	-	10,219	10,311	8,762

AShAK realizon të hyra nga shitja e librave të cilat derdhen direkt në Buxhetin e Kosovës. Në vitin 2016 ishin edhe 662€ të hyra nga kompensimi i dëmeve nga kompanitë e sigurimeve. Gjithsej të hyra në vitin 2016 ishin 10,219€.

Tabela 2. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ²	2016 Realizimi	2015 Realizimi	2014 Realizimi
Burimet e Fondeve:	1,084,851	1,159,523	1,147,893	1,148,202	1,147,096
Granti i Qeverisë -Buxheti	1,084,851	1,142,501	1,142,501	1,145,202	1,142,093
Donacionet e brendshme	0	3,000	3,000	3,000	3,000
Donacionet e jashtme	0	14,022	2,392	0	2,000

² Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 74,672€. Ndryshimi është rezultat i rishikimit të buxhetit dhe vendimeve të Qeverisë në fund të vitit.

Në vitin 2016, akademia ka përdorur 99% të buxhet final ose 1,147,893€, nivel i njëjtë me vitin e kaluar. Realizimi i buxhetit mbetet në nivel të kënaqshëm dhe më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

Tabela 3. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2016 Realizimi	2015 Realizimi	2014 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	1,084,851	1,159,523	1,147,893	1,148,202	1,147,097
Pagat dhe Mëditjet	754,908	685,998	685,998	752,691	732,671
Mallrat dhe Shërbimet	324,943	455,713	455,713	339,541	405,911
Shërbimet komunale	5,000	3,182	3,182	3,470	3,515
Subvencionet dhe Transferet	0	14,630	3,000	3,000	5,000
Investimet Kapitale	0	0	0	49,500	0

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë dhënë si në vijim:

- Zvogëlimi i buxhetit për paga dhe mëditje për 28,910 është rezultat i vendimit të qeverisë për kursime buxhetore;
- Me rishikim të buxhetit kategoria mallra dhe shërbime fillimisht kishte rritje për 150,000€. Më vonë me vendim të Qeverisë buxheti për këtë kategori është zvogëluar për 19,230€, në emër të kursimeve buxhetore;
- Buxheti për shërbime komunale ishte reduktuar për 1,819€ me vendim të qeverisë. Buxheti për shërbime komunale ishte shpenzuar 100%; dhe
- Me buxhetin fillestar nuk janë paraparë mjete tek subvencionet dhe transferet, derisa në buxhetin final përfshihen grantet e donatorëve të brendshëm në vlerë 14,630€. Grantet janë nga "Salbatring Internacional" dhe "Marigona Residence". Këto shpenzohen për blerjen e librave dhe mbështetjen e të rinjëve në fushën e shkencës dhe artit. Buxheti i kësaj kategori është shpenzuar 20%, mirëpo kjo nuk tregon performancë të ulët ngase me marrëveshje është paraparë këto mjete të shpenzohen pjesërisht në vitin 2016 dhe pjesa më e madhe në vitet e ardhshme.

3.1.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara në 2016 ishin 10,219€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga shitja e librave dhe botimeve të financuara nga ASHAK. Të hyrat nuk përdoren nga akademia për qëllime të saj, por barten në buxhetin e Kosovës.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.1.2 Pagat dhe mëditjet

AShAK-u 59% të buxhetit total e shpenzon në kategorinë e pagave dhe mëditjeve, të cilat paguhen përmes një sistemi të centralizuar. Kontrollat kyçe e konfirmojnë saktësinë dhe plotësinë e pagesave. Buxheti final për paga dhe mëditje në vitin 2016 ishte 685,998€. Prej tyre ishin shpenzuar 685,998€ apo shprehur në përqindje 100% e buxhetit të ndarë në këtë kategori.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.1.3 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime në vitin 2016 ishte 455,713€, të cilat ishin shpenzuar 100%. Mbi 50% e këtij buxheti shpenzohet për shërbime intelektuale dhe këshillëdhënëse, dhe pjesa tjetër për sigurim të ndërtesave, për blerje të librave dhe veprave artistike, botime e publikimeve, etj.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.1.4 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 14,630€. AShAK i kishte shpenzuar 3,000€ për stimulim në fushën e shkencës dhe artit si dhe 2,391€ të vitit të kaluar ishin transferuar dhe shpenzuar tek kategoria e Mallrave dhe Shërbimeve, për blerjen e librave për bibliotekën e AShAK.

AShAK ka marrëveshje me dy donatorë të brendshëm: "Salbatring Internacional" dhe "Marigona Residence" dhe në bazë të marrëveshjeve mjetet pritet të shpenzohen prej vitit në vit dhe vet AShAK bënë mbikëqyrjen dhe monitorimin e donacionit.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.2 Pasuritë

3.2.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

AShAK kishte menaxhuar pasuritë e veta në përputhje me kërkesat e rregullores MF nr.02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare të organizatave buxhetore. Regjistri i pasurisë ishte azhurnuar vazhdimisht nga zyrtari i pasurisë andaj regjistri ishte i plotë dhe i saktë. Po ashtu inventarizimi ishte kryer në fund vit në përputhje me kërkesat e rregullës financiare.

Vlera neto e pasurive të shpalosura në PFV ishte 138,123€. Prej tyre 82,123€ ishin pasuri kapitale (mbi 1,000€) dhe 56,000€ ishin pasuri jo-kapitale (nën 1,000€). Vlera e stoqeve e shpalosur në PFV ishte 389,000€.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.3 Obligimet e papaguara

Pasqyra e obligimeve ndaj furnitorëve në fund të vitit 2016 ishte 4,491€. Krahasuar me vitin paraprak, obligimet janë zvogëluar për rreth 80%. Obligimet e vitit 2016 kryesisht kanë të bëjnë me mirëmbajtje të teknologjisë informative, shërbime komunale, sigurim i ndërtesës etj.

Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit

Përgjegjësitë e Auditorit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisje janë dhënë në hollësi në Opinionin e përcaktuar në kapitullin 1.2 të këtij raporti.

Derisa rezultat kyç i punës sonë është opinionin e auditimit, ky raport pasqyron tërësinë e punës sonë me fokus të veçantë edhe në Çështjet e Qeverisjes përfshirë Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Kjo e fundit mbështetet në programin tonë të gjerë të auditimit të pajtueshmërisë të bazuar në rrezik.

Përmbledhja e përgjithshme ka për qëllim t'i nxjerrë në pah gjetjet kryesore të auditimit dhe veprimet kyçe për të cilat Kryetari duhet të sigurojë se janë ndërmarrë për t'i adresuar dobësitë e identifikuara të menaxhimit/të kontrollit.

Raporti i detajuar ofron një përmbledhje të gjerë të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në përcaktimin e shkakut të të gjeturave të auditimit dhe në dhënien e rekomandimeve të përshtatshme për t'i adresuar ato. Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuara gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë - Çështjet të cilat nëse nuk adresohen mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë gjithashtu do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen me prioritet të ulët i janë raportuar veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në atë masë sa që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të

cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca III: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
2.4 Lista kontrolluese e vetvlerësimit të MFK-së	Kryetari i akademisë duhet të sigurojë se është zbatuar një rishikim për plotësimin e listës kontrolluese të vetvlerësimit dhe që është bërë adresimi i fushave me dobësi në mënyrë pro aktive. Duhet të aplikohet një mekanizëm i rishikuar për ta konfirmuar saktësinë e listës kontrolluese si dhe për të siguruar dokumentacionin mbështetës.	Po		
2.4.1 Menaxhimi i rrezikut	Kryetari i akademisë duhet të sigurojë se është deleguar përgjegjësia e drejtpërdrejtë për menaxhimin e rrezikut tek një staf përkatës dhe të sigurojë raportim mujor për zbatimin e kërkesave në këtë fushë dhe për rreziqet që janë duke u menaxhuar..	Po		
3.4 Prokurimi	Kryetari i akademisë duhet të sigurojë se është bërë një planifikim më i mirë i blerjeve në të ardhmen, me një koordinim më të mirë ndërmjet departamenteve. Një proces formal i diskutimit duhet të iniciohet për të vlerësuar nevojat për blerje dhe sasinë e përafërt.	Po		

Shtojca IV: Letërkonfirmimi



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2016 dhe për implementimin e rekomandimeve.

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmojmë se:

- Kemi pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës (ASHAK), për vitin 2016 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- Pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kemi ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit, si dhe
- Brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzojmë një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Lendita Juniku-Pula,
Sekretare e Akademisë



Data: 20 qershor 2017, Prishtinë